



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1130/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Burim Kelmendi, zyrtar ligjor i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Burim Kelmendi, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, me shenjën ZL.Anr.1130/2017, të datës 18.12.2017, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Rivotim për Kryetar të Komunës së Istogut të mbajtura më datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1130/2017 me datën 18.12.2017, nga Burim Kelmendi, zyrtar ligjor në subjektin politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, në të cilën pretendon se në vendvotimin 0605C/01R në fshatin Zallq komuna Istogut, ka pasur raste të votimit të dyfishte, afër 10 votues kanë votuar nga 2 herë. Sipas parashtruesit të ankesës këto parregullsi janë evidentuar nga vëzhguesit e organizatës Demokracia në Veprim (DNV).

Si provë ka bashkangjitur një letër të printuar nga portali Express.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, verifikoi Librin e Votimit të vendvotimit me numër 0605c/01R dhe nuk gjeti asnjë vërejtje për të cilën kanë evidentuar anëtarët e këshillit të vendvotimit si dhe në verifikimin e Listës Përfundimtare të votuesve gjeti se numri i nënshkrimeve të votuesve është i barabartë me numrin e votave të cilat janë evidentuar në Librin e votuesve, kështu që pretendimet në ankesë se ka pasur raste të votimit të dyfishte i konstatoi si të pabaza.

Ndërsa në raport me pretendimet që rrjedhin nga se shkrimi i postuar në portalin Express Paneli vlerëson se lidhur me të gjeturat në procesin e votimit në Komunë e Istogut gjatë ditës së votimit me dt.17.12.2017 nga Demokracia në Veprim (DNV) nuk paraqet provë në bazë të së cilës mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me shkelje të cilat minojnë integritetin e zgjedhjeve. Po ashtu Demokracia në Veprim ndonëse ka qenë e certifikuar për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe e njëjta ka mundur të paraqes në PZAP të gjeturat-shkeljet përmes ankesës, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, andaj raportimet e publikuara në media nuk mund të merren si prova në bazë të cilave mund të vendoset se ka pasur parregullsi.

Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117.3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se: “vendosja për apele dhe ankesa nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse ankesën e ankuesit e refuzoj si të pa bazuar..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.1130/2017 më datën 19.12.2017.

Kryesuesë e Panelit
Fejzullah Rexhepi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*